



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 07.08.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **05.08.2025**, të parashtruar nga **DataProgNet SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ritender “Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemeve Medlis dhe SMSN” Llot 2** me nr. prokurimi 206-25-5404-2-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Pranohet**, si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE DataProgNet SH.P.K. e dt. 05.08.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Ritender “Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemeve Medlis dhe SMSN” Llot 2** me nr. prokurimi 206-25-5404-2-2-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK, të datës 01.08.2025;
2. **Anulohet**, Njoftimi mbi vendimin e AK i datës 01.08.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, e kthen në rivlerësim aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

OE Tech Vision shpk me datën 01.08.2025, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ritender “Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemeve Medlis dhe SMSN” Llot 2** me nr. prokurimi 206-25-5404-2-2-1. Autoriteti Kontraktues me datën 07.08.2025 e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

Autoriteti Kontraktues (AK) ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik (LPP) dhe Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (RrPP). Në vijim po paraqesim rrethanat, faktet dhe argumentet për shkeljet e dispozitave të LPP-së dhe RrPP-së.

- Neni 1 Qëllimi
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Pretendimet ankimore te OE ankues:

- *Me datë 01.08.2025 nga Autoriteti Kontraktues (AK) përmes sistemit elektronik eProkurimi jemi –njoftuar me Letërat standert për tenderuesit e eliminuar dhe për tenderuesin e sukseshëm.*
- *Me datë 04.08.2025 përmes sistemit eProkurimi kemi bërë kërkesë konform ligjit të KRPP-së dhe kemi kërkuar qasje zyrtare në ofertën e Operatorit Ekonomik (OE) të propozuar si tenderues i suksesshëm "CMD SH.P.K", pjesmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.*
- *Po në të njejtën ditë na është aprovuar qasja, nga dokumentet që na janë ofruar nga Autoriteti Kontraktues (AK) në ditën qasjes kemi vërejtur se OE "CMD SH.P.K" i rekomanduar për kontratë vetëm i ka nënshkruar dhe vulosur deklaratën për mirembajtje dhe avancim, deklaratë për specifikim teknik, por ashtu nuk ka ofruar as edhe një zgjidhje më të hollësishme të sistemit si Plani Dinamik i Avancimit dhe Mirëmbajtjes, Propozimi Teknik i Avancimit dhe Mirëmbajtjes të cilat janë të detyrueshme për çdo ofertues që me ju përgjegj me ofertë teknike kërkesave teknike të dosjes së tenderit e sidomos të një sistemi të rëndësishëm dhe të natyrës komplekse siç është projekti në fjalë me titull: Ritender "Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemeve Medlis dhe SMSN" Llot 2. Bazuar në faktet se nga OE CMD SH.P.K" nuk është ofruar as edhe një zgjidhje më të hollësishme për avacim dhe mirëmbajtje të sistemit duke mos ofruar Plani Dinamik të avacimit dhe mirëmbajtjes dhe as Propozimi Teknik, kuptohet qartë se ky OE nuk e ka të qartë se për çka ka ofertura.*
- *"OE CMD SH.P.K" nuk i plotëson as "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2" siç janë kërkuar në dosjen e tenderit:
Listën e stafit të propozuar për këtë projekt nga "OE CMD SH.P.K", janë shtetas të Republikës së Shqipërisë, ku asnjëri prej tyre nuk ka prezantuar dëshmi të nostrifikimit të diplomave për të pasur të drejtë ligjore për të ushtruar profesionin në Republikën e Kosovës.*

1. Kërkesa (1) DT: Operatori Ekonomik duhet të dëshmoj se ka realizuar se paku një projekt në zhvillimin dhe implementimin ose mirëmbajtje të softuerit e të paktën 1 (një) projekti në shëndetësi tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të këtij Njoftimit për kontratë.
 - Sipas të dhënave zyrtare të regjistrimit në Sistemin ARBK, OE "CMD SH.P.K" është themeluar më datë 07.04.2025, ndërsa kërkesa për përvojë në dosjen e tenderit për Lotin 2 parasheh që OE duhet të ketë realizuar së paku një projekt në fushën e shëndetësisë gjatë tri (3) viteve të fundit pra në periudhën 27.06.2022 – 27.06.2025. Duke qenë se kjo kompani është e re, nuk ka ekzistuar gjatë pjesës më të madhe të kësaj periudhe, është e pamundur ligjërisht dhe praktikisht që ajo të ketë përvojën e kërkuar, që të ketë realizuar projekte të tilla në sektorin e shëndetësisë ose mirëmbajtje/implementim të softuerëve në periudhën e kërkuar. OE "CMD SH.P.K" nuk ka realizuar asnjë kontratë në institucione shtetërore të sektorit të shëndetësisë. Dëshmia e ofruar është një kontratë me një subjekt privat, jo e natyrës së ngjashme, dhe nuk e përmbush kriterin e përvojës.
2. Kërkesa (2) b.1 (një) Analist i projektit - Inxhinier i diplomuar i Kompjuterikes me telekomunikacion ose Master i shkencave ose inxhinierisë kompjuterike , me përvojë pune minimum 5 vjeçare pas diplomimit në cilësinë e analistit të sistemeve softuerike (të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server)
 - OE "CMD SH.P.K" Staf i propozuar nuk ka përvojë në projekte të ngjashme, ka propozuar staf me nivel akademik i cili nuk i pergjigjet kërkesës së dosjes tenderit, më konkretisht ka propozuar ekspert që nuk posedon diplomë (kualifikim të përshtatshëm profesional) siç është kërkuar në Kërkesa (2) DT: Analist i projektit.

Andaj, bazuar në këto fakte, pasi që kemi pasur qasje zyrtare konform Ligjit të KRPP-së në ofertën teknike që ka dhënë OE "CMD SH.P.K" dhe pasi që kemi lexuar dhe analizuar me kujdes ofertën dhe e kemi kuptuar se ky OE nuk e ka të qartë natyrën, kompleksitetin dhe rëndësinë e këtij sistemi shumë të rëndësishëm për MSH-në dhe nuk i plotësson kërkesat dhe kriteret për të u shpërblyer me kontratë.

AK duke shpërblyer me njoftim të dhënies së kontratës këtë OE ka shkelur nenin 1, nenin 7 dhe nenin 59 të LPPS-së.

Andaj, bazuar në këto fakte, pasi që kemi pasur qasje zyrtare konform Ligjit të KRPP-së në ofertën teknike që ka dhënë OE "CMD SH.P.K." dhe pasi që kemi lexuar dhe analizuar me kujdes ofertën dhe e kemi kuptuar se ky OE nuk e ka të qartë natyrën, kompleksitetin dhe rëndësinë e këtij sistemi shumë të rëndësishëm për MSH-në dhe nuk i plotësson kërkesat dhe kriteret për të u shpallur i përgjegjshëm edhe pse nuk është shpërblyer me kontratë.

AK duke nxjerrë të përgjegjshëm OE "CMD SH.P.K." ka shkelur nenin 1, nenin 7 dhe nenin 59 të LPPS-së.

Siç jeni në dijeni Sistemin MEDLIS e ka zhvilluar kompania DataProgNet SH.P.K. e kontraktuar nga MSH- financuar nga Banka Botërore. Gjatë periudhës së zhvillimit dhe

maksimum dhe seriozitet të lartë profesional. Nga MSH pas përfundimit me sukses të këtij sistemi posedojmë Referencë POZITIVE.

Duke marrë për bazë këto fakte kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues "Ministria e Shëndetësisë", që të ANULOJ vendimin e datës 01.08.2025 dhe pasi që OE CMD SH.P.K nuk është i përgjegjshëm lëndën ta kthej në RIVLERSIM.

Nëse nuk merren për bazë faktet e paraqitura më lartë gjatë kërkesës sonë për rishqyrtim, jemi të obliguar që brenda afateve ligjore të dorëzojmë ankesën në OSHP.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmi material i përgatitjes së ofertës si dhe dëmet tjera do të pasqyrohen pas një analize të detajuar profesionale.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore:

E kemi shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim të dërguar nga DataProgNet SH.P.K. në kete procedurë dhe konsiderojme se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara.

- Sa i perket pretendimit se OE i rekomanduar CMD SH.P.K. nuk ka ofruar zgjidhje me të hollësishme teknike rreth mirëmbajtjes dhe avansimit të sistemit, por vetëm i ka nënshkruar deklaratën për mirëmbajtje dhe avansim si dhe deklaratën për specifika teknike, konsiderojmë se ky pretendim është i pa bazuar, meqenëse në DT të Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, janë përshkruar objektivat e projektit dhe shërbimet që duhet të kryhen nga OE i kontraktuar, ndërsa të kriteret në FDT nuk kemi kërkuar ndonjë kërkesë/dëshmi që duhet të ofrojnë ofertuesit rreth mënyrës se si do të kryejnë këto shërbime.

Mirëpo meqenëse të dy ofertuesit i kemi ofruar Propozimet e juaja teknike edhe pse nuk janë kërkuar, konsiderojmë që këto propozime të shqyrtohen edhe një herë gjatë rivlerësimit.

- Sa i perket pretendimit se OE i rekomanduar CMD SH.P.K. ka ofertuar me staf nga Republika e Shqipërisë, diplomatë të cilëve janë të pa nostrifikuar, konsiderojmë se ky pretendim është i pa bazuar, meqenëse nostrifikimi i diplomave të inxhinierëve nuk është kërkuar si kriter, andaj kjo nuk është e specifikuar as në legjislacionin e prokurimit. Procesi i nostrifikimit zgjatë si proces dhe një kërkesë e tillë mund të jetë diskriminuese dhe të ua pamundësojë ofertimin OE.

Me rregulloren e fundit të prokurimit është ndaluar edhe noterizimi i dokumenteve, andaj mund të perdoret parimi i njëjti që nuk kërkohej as nostrifikimi.

Sipas përvijës në rast të tillë, nostrifikimi kërkohej për stafin vendor të RK që janë shkolluar dhe diplomuar jashtë vendit, e të cilët diplomën e shtetit tjetër duhet ta nostrifikojnë në RK, ndërsa në këtë rast kemi të bëjmë me staf të jashtëm nga Republika e Shqipërisë dhe kjo nuk kërkohej.

- Sa i perket pretendimit se OE i rekomanduar CMD SH.P.K. nuk ka realizuar projekte ne tre vitet e fundit siç eshte kerkuar, konsiderojme se ky pretendim eshte i bazuar, meqense ne kuader te kerkeseve mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 – Kerkesa nr. 1 eshte kerkuar: ***Operatori Ekonomik duhet të dëshmoj se ka realizuar se paku nje projekt në zhvillimin dhe implementimin ose mirëmbajtje të softuerit e të paktën 1 (një) projekti në shëndetësi tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit te këtij Njoftimit për kontrate.***

Ne Listen e projekteve te prezantuara nga OE i rekomanduar CMD SH.P.K. eshte edhe projekti nr. 4 me titullin **Instalimi i programit financiar/kontabilitet, menaxherial dhe administrativ 2022-2024** ne vlere 5,980.00 euro per Ordinancen stomatologjike "Nika Dent"

Konsiderojmë qe duhet te rishqyrtohet edhe një here ky projekt gjate rivlerësimit, meqenëse referenca eshte lëshuar një vit me vone se sa realizimi dhe ka dallim substancial ne mes titullit ne liste dhe përshkrimit te bere ne referencën e lëshuar para ofertimit me dt. 06.06.2025.

- Sa i perket pretendimit se OE i rekomanduar CMD SH.P.K. nuk e ka plotesuar kerkesen nr. 2 rreth Analistit te projektit, konsiderojme se ky pretendim eshte i bazuar, gjate vlerësimit te aktivitetit kjo çështje ka qene e trajtuar nga komisioni vlerësues por eshte konsideruar si devijim i vogël konform nenit 59.4 te LPP-se, andaj edhe kjo çështje duhet te rishikohet gjate rivlerësimit.

- Sa i perket pretendimit se OE i rekomanduar CMD SH.P.K. nuk e ka te qarte natyren, kompleksitetin dhe rendesine e ketij sistemi shume te rendesishem per MSH-ne, kjo mund te konsiderohet vetem si dyshim nga ana juaj, te cilin ne nuk mund te masim apo vertetojme ne kete faze, por mbetet ne shihet ne vazhdim gjate implementimit te kontrates

Ne baze te pretendimeve dhe sqarimeve te lartcekura, AK-MSH vendos qe ky aktivitet te kthehet ne rivleresim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit